

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër personit të kërkuar L.Sh., nga Durrësi, Republika e Shqipërisë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i personit të kërkuar L.Sh., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PK.nr.103/2017 datë 06.10.2017, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.857/2017 datë 17.10.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 26 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të personit të kërkuar L.Sh., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PK.nr.103/2017 datë 06.10.2017, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit, PN.nr.857/2017 datë 17.10.2017.

A r s y e t i m i

Shteti Italian në përputhje me Konventën Evropiane për Ekstradim të vitit 1957, në rrugë diplomatike, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, ka paraqitur kërkesë për ekstradimin e të dënuarit L.Sh., shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili nga autoritetet policore të Kosovës, ishte arrestuar sipas një fletë arresti ndërkombëtar. I kërkuar në një proces gjyqësor, që ishte mbajtur në mungesë të akuzuarit nga gjykata Italiane, në përputhje me Kodin e Procedurës penale të Italisë, ishte shpallë fajtor për shkak të veprës penale mbajtje e shpërndarje në bashkëpunim të lëndëve narkotike në vazhdim nga neni 110 Kodit Penal Italian (Trafikim me substanca

narkotike e paraparë me Kodin penal të Republikës së Italisë), dhe ishte gjykuar, me dymbëdhjetë (12) vjet burgim, dhe dënim me gjobë në shumën prej pesëdhjetëmijë (50) €, ndërsa me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Barit, të datës 06.02.2017, është ndryshuar aktgjykimi penal i datës 07.02.2006. i Gjykatës së Barit, i akuzuari është dënuar me dhjetë (10) vite burgim, dhe me dënim me gjobë në shumën prej dyzetmijë (40) €.

Vendimi i Gjykatës Themelore në Prizren

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, duke vendosur lidhur me kërkesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren , me aktvendimin PK-nr.103/17, datë 06.10.2017, ka konstatuar **se janë përmbushur** kushtet ligjore nga Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, nga konventat ndërkombëtare dhe evropiane, për ekstradimin në shtetin Italian, e të dënuarit L.Sh. nga Durrësi, shtetas i Republikës së Shqipërisë, i kërkuar nga autoritetet e shtetit të Italisë, për shkak se është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtje e shpërndarje në bashkëpunim të lëndëve narkotike në vazhdim nga neni 110 Kodit Penal Italian (Trafikimi me substanca narkotike e paraparë me Kodin Penal të Republikës së Italisë).

Vendimi i gjykatës së Apelit

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr.857/17 të datës 17.10.2017, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të kërkuarit për ekstradim.

Mjeti i jashtëzakonshëm juridik

Kundër këtyre aktvendimeve në afat ligjor ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i personit të kërkuar, av. N.Q., për shkak të shkeljeve të dispozitave nga Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale edhe atë neni 13,17 par.3,4 dhe 5 dhe neni 18 të këtij ligji dhe shkeljeve ligjore të dispozitave të Konventës Evropiane për Ekstradim dhe dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga neni 24, 31 dhe 33 të Kushtetutës, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesën e mbrojtësit të personit të kërkuar ta aprovojë si të drejtë dhe aktvendimin e kundërshtuar ta ndryshojë, ashtu që ta refuzojë kërkesën për ekstradimin, i paraqitur nga shteti i Italisë, ose që aktvendimin ta prishë, dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Mbrojtësi i personit të kërkuar, av. N.Q., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon: se aktvendimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje ligjore dhe atë të shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë dhe shkeljeve tjera të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuar me Kushtetutë dhe Konventën për të drejtat e njeriut. Sipas mbrojtësit në aktvendim nuk janë dhënë arsye të qarta dhe logjike për bazën ligjore për lejimin e ekstradimit, nga dispozitivi i aktvendimit nuk mund të kuptohet se cila është kërkesa, çfarë numri mban dhe mbi cilën bazë është paraqitur, cila është arsyeja e kërkesës. Kërkesa për ekstradimin e Ministrisë së drejtësisë e datës 24.07.2017, është e paqartë, nuk është përkthyer mirë, dhe nuk mund të kuptohet se kush është dënuar me këto vendime, sa është dënimi. Më tej në kërkesë pretendohet se është shkelur parimi “ Ne bis in idem” sepse Gjykata e Durrësit në Republikën e Shqipërisë, për të njëjtën çështje penale ka zhvilluar procedurën e ekstradimit e këtij të dënuari, dhe ka refuzuar kërkesën për ekstradimin, në mungesë të paraqitjes së një kërkesë të arsyetuar nga shteti kërkuar. Sipas tij procedura e ekstradimit ka përfunduar në procedurë gjyqësore në Republikën e Shqipërisë, prandaj përsëritja e procedurës së njëjtë në Gjykatën Themelore në Prizren është në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të Konventës Evropiane, dhe neni 13, 17, 18. Të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Veprimet e tilla sipas pretendimeve nga kërkesa, bien ndesh edhe me dispozitat e nenit 31 dhe 34 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Opinioni i prokurorit, nga zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Prokurori **nga zyra e Kryeprokurorit të Shtetit**, me parashtrësën, KMLJP.II.nr.222/17 të datës 21.11.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të personit të kërkuar për ekstradim, të refuzohet si e pabazuar.

Vendimi i Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, shqyrtoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, shkresat tjera në këtë çështje të ekstradimit, dhe konstatoi se **kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar për arsyet si në vijim:**

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë i vërtetuar nga Gjykata e Apelit, rezulton të jetë i bazuar, dhe ky vendim nuk ka cenuar asnjë nga të drejtat e të dënuarit (L.Sh.), të parashikuara nga Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, të drejta e garantuara me instrumentet ndërkombëtare, apo me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, siç pa të drejtë pretendohet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të personit të kërkuar për ekstradim, janë më tepër të natyrës teknike, por jo substanciale - përmbajtësore, që do e vinin në dyshim qëndrueshmërinë e vendimit të gjykatës së shkallë së parë, për lejimin e ekstradimit të këtij personi. Në kërkesë pretendohet se ka pengesa për ekstradim, në mesin e tjerave edhe për faktin se kjo çështje konsiderohet e gjykuar, ngase sipas mbrojtësit në Republikën e Shqipërisë, është zhvilluar procedurë gjyqësore për ekstradimin e këtij personi, por kërkesa është refuzuar me vendim të formës së prerë. Pretendimet e këtilla dalin të pa bazuara për këto arsye :

Pengesat për ekstradim

Sipas Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale i cili bazën e ka në standardet ndërkombëtare për ekstradimin, ekstradimi nuk do lejohej nëse ekzistojnë këto pengesa: **Shtetësia si pengesë për ekstradim, dënimi dhe diskriminimi, shkaqet humanitare, (mosha e shtyrë, sëmundja, mituria, nëse personi ka jetuar gjatë në atë shtet, etj.) Veprat penale si pengesë për ekstradim (veprat penale politike, veprat penale ushtarake; veprat penale financiare ; veprat penale të shtypit; veprat penale që ndiqen sipas padisë private), masa e ulët e dënimit të paraparë ose shqiptuar - parimi i ekstradibilitetit (dënim së paku një vit burg, për ekzekutimin e dënimit kohëzgjatja e dënimit ose dënimit të mbetur është mbi 4 muaj), mundësia e shqiptimit të dënimit me vdekje dhe me burgim të përjetshëm, torturat, trajtimi çnjerëzorë, degradues ose keqtrajtimi, klauzola diskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut.**

Shkaqet procedurale-pengesat procedurale

Ekzistimi i aktgjykimit të plotfuqishëm për të njëjtën çështje (*parimi res judicata*), parashkrimi dhe litispendenca.

Parimi “Ne bis in idem “

Sipas nenit 13 të Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale Ekstradimi nuk lejohet: “nëse është dhënë një vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore vendore kundër personit të kërkuar për veprën apo veprat penale për të cilat kërkohet. Ekstradimi mund të lejohet nëse organet gjyqësore vendore kanë vendosur të mos fillojnë ose të ndërpresin procedurën gjyqësore

në lidhje me veprën apo veprat e njëjta penale. Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë vendim i formës së prerë nga organet gjyqësore të një shteti të tretë kundër personit të kërkuar për veprën ose veprat penale për të cilat kërkohet ekstradimi dhe nëse ekziston një marrëveshje ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe atij shteti për njohjen dhe ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve penale”.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në rastin e të dënuarit L.Sh., janë përmbushur të gjitha pre supozimet ligjore, dhe ato nga instrumentet ndërkombëtare, për ndihmën juridike ndërkombëtare - për ekstradimin e tij në Shtetin Italian, dhe se në rastin konkret, nuk ekziston asnjë nga pengesat ligjore e theksuara më sipër, e që do e pamundësonin ekstradimin, siç pretendohet me kërkesë. Në rastin e L.Sh. nuk bëhet fjalë për asnjë pengesë ligjore për ekstradim, e aq më pak për parimin “**ne bis in idem**“, ngase fakti se Gjykatat në Republikën e Shqipërisë ia kanë ndërprerë paraburgimin L.Sh., ngase shtetit Italian nuk e ka përmbushur një kërkesa nga konventat, që brenda dyzet (40) ditësh, të deponoj kërkesën për ekstradim, nuk do të thotë kemi të bëjmë me çështje të gjykuar për gjykatat e Kosovës, aq më parë kur gjykata Shqiptare nuk ka vendosur për ekstradimin, por L.Sh. i ka hequr paraburgimin. Edhe sikur gjykata Shqiptare të kishte refuzuar kërkesën për ekstradim, për gjykatat e Kosovës nuk do ishte “res judicata“ dmth. nuk do vinte në shprehje aplikimi i parimit “Ne bis in idem” siç po pretendohet me kërkesë, u tha dhe u sqarua më sipër se kur aplikohet ky standard.

Kushtet për ekstradim në bazë të Traktatit për ekstradim në mes të Republikës së Kosovës dhe Shtetit Italian, në rast të gjykimit në mungesë

Objektit i traktatit të lidhur në mes të **Republikës së Kosovës dhe Shtetit Italian**, ka qenë edhe çështja e ekstradimit, kur i kërkuar ka qenë i paarritshëm për organet Italiane, dhe është gjykuar në mungesë. Në nenin 3 të Traktatit përcaktohet: “nëse procedurat janë zbatuar në mungesë të pandehurit, atëherë kjo nuk është arsye për refuzimin e kërkesës për ekstradim, nëse personi ka të drejtë gjykimin e ri me kërkesën e tij. Autoritetet e Kosovës, nga Qeveria e Republikës së Italisë, kanë marrë garancione se me kërkesën e të ekstraduarit, konform nenit 175 par 2.2 bis . k.p.p; atij do i mundësohet rihapja e çështjes penale, nëse ai e kërkon rishikimin e procedurës penale, në afatin e paraparë ligjor. Nga kjo rezulton se është përmbushur edhe standardi për rigjykimin e çështjes nga gjykatat Italiane, nëse këtë e kërkon i dënuar, dhe në rrethana të këtylla nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për ekstradimin e tij në shtetin kërkuar.

Nga sa u parashtrua rezultojnë të pa bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë , andaj në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.325/2017, më 26 mars 2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa